



Vërtetimet

Informatat në vijim iu referohen vërtetimeve të kopjeve dhe të nënshkrimeve. Informata mbi legalizimin dhe vërtetimin e çertifikatave zyrtare të Republikës së Kosovës gjeni në fletinformacionet „Legalizimi“, gjegjësisht „Vërtetimi i çertifikatave“.

Vërtetimi i kopjeve

Nëse ju duhet të paraqitni dokumente, si dëftesa, dokumente të identifikimit, apo çertifikata të gjendjes civile për t'i përdorur ato në Gjermani, ndërsa dëshironi t'i mbani origjinalet, ambasada mund t'i vërtetojë kopjet e këtyre dokumenteve.

Për të vërtetuar që një kopje, apo një duplikatë përputhet me origjinalin e një çertifikate, duhet të paraqitet edhe origjinali i çertifikatës. Ju lutemi të paraqitni aq kopje sa ju duhen që të vërtetohen. Origjinalet nuk guxojnë të jenë të plastifikuara. Kopjet nuk bën të jenë të ngjitura mes vete. Vërtetimi nuk i referohet përmbajtjes së çertifikatës.

Tarifa për vërtetimin e një kopje, sipas Rregullores për Shpenzime jashtë vendit për një dokument deri në 10 faqe në alfabet latin është 10,- euro dhe 1,- euro për secilën faqe pasuese.

Vërtetimi i nënshkrimeve

Nëpunësit konsullorë mund të vërtetojnë një nënshkrim, apo shenjë dore, nëse ato bëhen, ose njihen para nëpunësit konsullor. Për këtë arsye është e domosdoshme paraqitja personale e personit, nënshkrimi apo shenjat e gishtërinjve të të cilit mëtohet të vërtetohen.

Në rastin e vërtetimit të nënshkrimit kontrollohet dhe vërtetohet vetëm identiteti i nënshkruesit. Me këtë rast personi nuk informohet lidhur me rëndësisinë dhe pasojat e deklaratës. Megjithatë nëpunësi konsullor obligohet – rëndom përmes një bisedeje të shkurtër – që të sigurohet që nënshkruesi është i vetëdijshëm, çfarë nënshkruan. Ambasada në këto raste as bën përkthimin me shkrim as aty për aty përkthimin verbal të deklaratës së paraqitur në një gjuhë të huaj.

Për llogaritjen e tarifës sipas Rregullores së Tarifave jashtë vendit vlera e transaksionit ligjor definohet në përputhje me veprimin zyrtar përkatës (në rast të transaksioneve të patundshmërisë, p.sh. çmimi i blerjes, në rast të shoqërive kapitale, kapitali themelor). Vlera e tarifës është 20,- euro deri më së shumti 250,- euro.

Për vërtetim të nënshkrimit, luteni të paraqitni dokumentet në vijim:

1. Deklaratën që duhet nënshkruar;
2. Dëshminë lidhur me vlerën e transaksionit përkatës. Për deklaratë të miratimit nevojitet një kopje e kontratës, për vërtetime të regjistrimit tregtar, kopjet e vendimeve përkatëse të shoqërisë, apo çertifikatat e themelimit të noterizuar;
3. Pasaportën ose letërnjoftimin tuaj valid.

Shembuj për vërtetime të nënshkrimeve:

- Deklaratë e miratimit: Deklaratë me anë të së cilës një person, i cili është përfaqësuar gjatë lidhjes së një kontrate në Gjermani dhe i cili e miraton kontratën në mënyrë retrospektive
- Autorizimet me anë të të cilave dhënësi i autorizimit nuk obligohet në mënyrë të paravokueshme
- Kërkesat për vërtetime nga regjistri tregtar
- Parashtrimi i kërkesës për certifikatë policore
- Deklaratë për pranimin e trashëgimisë.

Informatat e tjera, përtej këtyre të paraqitura mund të gjeni në uebfaqen e Ministrisë Federale për Punë të Jashtme: <http://www.konsularinfo.diplo.de/urkundenverkehr>.

Ju lutem vini re që vërtetimet bëhen vetëm me termin të caktuar paraprakisht nëpërmejt portalit të termineve të ambasadës. Portalin e termineve e gjeni në vegzën në vijim:

https://service2.diplo.de/rktermin/extern/choose_realmList.do?request_locale=de&locationCode=pris.

Këto të dhëna jepen në bazë të informatave, të cilat i ka pasur në dispozicion Ambasada Gjermane në Prishtinë në kohën e publikimit. Nuk merret përgjegjësi për plotësinë, saktësinë dhe aktualitetin e informatave.